

**20260480834**

Në bazë të nenit 56 paragrafi (3) pika a) dhe paragrafi (4) të Ligjit për sigurimin pensional të detyrueshëm me financim kapital (“Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë” nr. 29/2002, 85/2003, 40/2004, 113/2005, 29/2007, 88/2008, 48/2009, 50/2010, 171/2010, 36/2011, 98/2012, 13/2013, 164/2013, 44/2014, 192/2015, 30/2016, 21/2018, 245/2018 dhe “Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut” nr. 180/2019, 103/2021, 86/2025 dhe 114/2025), Këshilli i Ekspertëve i Agjencisë për mbikëqyrje të financimit kapital të sigurimit pensional, në mbledhjen e mbajtur më 15.10.2025, miratoi:

**VENDIM PËR LARTËSINË E KOMPENSIMIT MUJOR QË E NGARKON AGJENCIA PËR MBIKËQYRJE TË FINANCIMIT KAPITAL TË SIGURIMIT PENSIONAL NGA SHOQËRITË PENSIONALE PËR VITIN 2026**

Neni 1

Lartësia e kompensimit mujor, që e ngarkon Agjencia për mbikëqyrje të financimit kapital të sigurimit pensional nga secila shoqëri pensionale për vitin 2026, është 0,6% e kontributeve totale të paguara gjatë muajit paraprak në çdo fond pensional që menaxhohet nga shoqëria pensionale.

Neni 2

Ky vendim hyn në fuqi ditën e ardhshme pas publikimit të tij në “Gazetën Zyrtare të Republikës së Maqedonisë së Veriut”, dhe do të publikohet pas marrjes së pëlqimit nga Kuvendi i Republikës së Maqedonisë së Veriut.

Ky vendim do të jetë në fuqi deri më 31.12.2026 dhe deri në marrjen e pëlqimit nga Kuvendi i Republikës së Maqedonisë së Veriut për vendimin mbi lartësinë e kompensimit mujor që e ngarkon Agjencia për mbikëqyrje të financimit kapital të sigurimit pensional nga shoqëritë pensionale për vitin 2027 dhe publikimin e tij në “Gazetën Zyrtare të Republikës së Maqedonisë së Veriut”.

Nr. 02-1362/4  
24.10.2025  
Shkup

Kryetari i Këshillit të  
Ekspertëve,  
**Remzi Bajrami, d.v.**